



Fermerët, qeveria me skemë të re financimi për bizneset e vogla në bujqësi

Faqe 5



Ministrja Denaj: Mbështesim 65 mijë fermerë me skemë të drejtpërdrejtë

Faqe 2



7 kompani shqiptare në panairin BIOFACH 2020, promovim bimëve mjekësore dhe ushqimit organik

Faqe 7



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit nëntor 2023

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 473
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

PROJEKT/ BUXHETI 2024 PËR MINISTRINË E BUJQËSISË

KASH PARASHTRON DISA SUGJERIME DHE PROPOZIME PËR PROJEKT/ BUXHETIN, REFERUAR FONDIT TOTAL TË SHPENZIMEVE ADRESUAR PROGRAMEVE, DUKE E KRAHASUAR ME BUXHETIN E VITIT 2023

Sipas KASH, qeveria ka programuar për Ministrinë e Bujqësisë për vitin 2024 krahasuar me shpenzimet e miratuara për vitin 2023, të ulë me 11.6% totalin e buxhetit të shpenzimeve; të ulë investimet e huaja dhe të brendshme në masën 28.8 % dhe të rrisë pagat në nivelin 28.4 %

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Një Udhëzues për Zgjedhje të Mençura në Karrierë dhe Zhvillim Personal

Këshillim në karrierë - Shtegu drejt suksesit



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2



Denaj dhe Balla në shkollën bujqësore "Rakip Kryeziu": Përgatiten profesionistët e rinj të bujqësisë



Faqe 2

SIPËRMARRËSET



Zëri i grave sipërmarrëse në bujqësi

Faqe 5

AGROTURIZËM

Rama: Agroturizmi do vijojë të rritet, po shtrihet deri në zona të thella



Faqe 10

BUJQËSI

Përfaqësues nga biznesi dhe institucionet e linjës diskutojnë mbi sfidat në sektorin e fruta-perimeve

Faqe 6

TEMA TË DITËS

- Denaj me fermerët në Fier: Të realizojmë bashkimin e operatorëve për të dalë në tregjet ndërkombëtare Fq.4
- Dëftesat tregtare, gati projekti. Qeveria kërkon të zgjidhë problemet e fermerëve Fq.4
- Lushnje - Fermerët eksperimentojnë me kivi, klima e nxehtë nuk i lejon të kultivojnë frutin Fq.11
- Rritja e kërpudhave të ngrënëshme në kushte shtëpiake - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

RISI ALBANIA

BUXHETI 2024

Një Udhëzues për Zgjedhje të Mençura në Karrierë dhe Zhvillim Personal

Këshillim në karrierë - Shtegu drejt suksesit

Këshillimi në karrierë është projektuar për të fuqizuar studentët në marrjen e vendimeve të informuara për një karrierë përmbushëse, si edhe të sigurojë disa mjete praktike për zhvillimin personal i cili është kyç në karrierë. Përmes një informimit falas pjesëmarrësit fitojnë vizion, qartësi, inkurajim dhe disa hapa praktike që u nevojiten për të naviguar në kompleksitetet e tregut modern të punës.

Në kuadër të mbështetjes që projekti RisiAlbania ka ofruar për rritjen e kapaciteteve të stafit të zyrave të karrierës pranë Universiteteve vijon me trajnimin rreth testeve të karrierës.

Testet e karrierës janë teste ndërkombëtare të standardizuara sipas nevojave të kontekstit shqiptar nga hulumtues të Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Universitetin e Lozanës në Zvicër dhe janë krijuar si një burim i hapur dhe mund të përdoren nga institucione që ofrojnë shërbime karriere dhe dëshirojnë të diversifikojnë dhe plotësojnë ofertën

e tyre. Duke qenë se rezultatet e testeve të karrierës kërkojnë interpretimin e një profesionisti të fushës, trajnimi i këshilluesve të

Vështirësitë në Procesin e Vendimarrjes për Karrierën, PGI - Inventari i matjes së interesave ose shkurt PGI (Personal Globe



karrierës është domosdoshmëri.

Janë në total katër teste të standardizuara ADOR - Analiza e kërkesës për orientim, CDDQ - Qëllimi i pyetësorit, CDDQ -

Inventory) dhe VISA - Qëllimi i "Vlerësimi i Statusit të Identitetit Profesional". Për secilin prej testeve janë planifikuar 2 ditë intensive trajnimi.

Testet e karrierës janë teste ndërkombëtare të standardizuara sipas nevojave të kontekstit shqiptar dhe janë krijuar si një burim i hapur dhe mund të përdoren nga institucione që ofrojnë shërbime karriere.

Rama thirrje prindërve: Jepuni fëmijëve zanat

Kryeministri Edi Rama ju ka bërë thirrje prindërve që fëmijët e tyre t'i drejtojnë drejt zanateve.

Gjatë fjalës së tij në një takim në Durrës, kryeministri

dhe e kuptojnë që nuk mundet të vazhdonin me teorinë "kur e mësova gomarin që të mos hajë, më ngordhi", që "fito për vete dhe paguaj punëtorët sa më pak". Tani është shumë e

marrin një zanat dhe me atë zatinin, jo vetëm mund të jetojnë mirë, por edhe mund të hapin dhe një biznes shërbimi. T'i çojnë fëmijët e tyre në arsimin profesional, t'u japin fëmijëve të tyre një të dhënë përmes zanatit, një punë të sigurt përmes zanatit. Mos të humbasin të ardhmen e fëmijëve duke insistuar që ata të shkojnë në gjimnaz dhe përsëri me 5, me 6, me 7. Dhe pastaj të synojnë të shkojnë në universitet për të marrë një diplomë me të cilën të vijnë vërdallë rrugëve, ose të mbetet pa universitet dhe zanat", deklaroi Rama.

Sipas tij, me atë zanat fëmijëve u kanë dhënë çelësin për të hapur derën e parë të jetës me një punë të tyren.

"Pastaj është zgjedhja e tyre, duan të punojnë këtu, apo atje, apo duan të ikin. Kjo është një zgjedhje e tyre. Po nuk është e drejtë, ndaj fëmijëve, ndaj këtyre fëmijëve, që jo gjimnaz, e pastaj ik të keqen mami se këtu nuk bëhet. Një zanat, një mundësi, që sot është kudo në Shqipëri dhe këtë e them me përgjegjësi dhe i sfidoj të gjithë ata që thonë të kundërtën. Të shkojnë në çdo kompani shqiptare dhe kur ta gjejnë një kompani që të thotë nuk kam punë dhe nuk kam nevojë, qoftë edhe për një, se ka që kanë nevojë edhe për 20, edhe për 30, edhe për 50. Atëherë të ma prezantojë, nuk ka", u shpreh ai.



Rama theksoi se duhen rritur kapacitetet e arsimit profesional.

"Në kushtet kur turizmi është qartësisht një industri e re, me një potencial të jashtëzakonshëm, ne na duhet të forcojmë jashtëzakonisht shumë arsimin profesional.

Ne na duhet të rrisim jashtëzakonisht shumë dhe shpejt kapacitetet e njerëzve tanë e më të rinjve, për të pasur, për të zotëruar ato zanate, të cilat është e pamundur. Këtë mund ta dëgjosh në të gjitha kompanitë shqiptare. Fatmirësisht kompanive shqiptare i ka ardhur mendja tani

qartë që duhet, dhe kanë filluar ta kuptojnë, por edhe ta bëjnë, të ofrojnë paga që janë paga të mira", u shpreh Rama.

Kryeministri Rama tha se të rinjtë mund të marrin një zanat me të cilin mund të jetojnë mirë, madje mund të krijojnë edhe biznes.

"Ka nisur një proces dhe unë përsëri u bëj thirrje prindërve të fëmijëve që janë me 6, me 7. Jo të gjithë do të bëhen intelektualë, apo do ushtrojnë profesione me doktoraturë. Një pjesë që mund të jenë po aq të talentuar, po aq të zotë, por që nuk janë të prirur për të ndenjur mbi libra, por mund të

Ministrja Denaj: Mbështesim 65 mijë fermerë me skemë të drejtpërdrejtë

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj prezantoi në Komisionin e Financave dhe Ekonomisë, projektbuxhetin e vitit 2024 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Denaj tha se, "vitet e fundit u tregua shumë qartë se mbështetja përmes skemave nacionale synonte mbështetjen e drejtpërdrejtë të fermerëve por njëkohësisht edhe formalizimin e tyre fondi i skemës ka pasur një hop cilësor në dy këto aspekte. Nga 8 mijë fermerët të mbështetur në 2010 sot në 2023 jemi me një mbështetje të 65 mijë fermerëve, kjo falë edhe mbështetjes më të fundit përmes aktit normativ të dhënë nga qeveria shqiptare".

Këtë vit, theksoi ministrja, me fondet buxhetore janë parashikuar të mbështeten drejtpërdrejtë 68% e të gjithë fermerëve me NIPT në shkallë vendi.

Sipas saj, skemat e

mbështetjes janë faktor kyç në mbështetjen e fermerëve.

"Në buxhetin e vitit 2024 janë adresuar 3.3 miliardë lekë për skemën e mbështetjes, por ne parashikojmë të rishikojmë disa elementë të efektivitetit të skemës, që në buxhet afatmesëm shkon më shumë se fondi i parashikuar këtë vit", u shpreh Denaj.

Ajo shpjegoi se, nevojat që ne do të depozitojmë në buxhetin afatmesëm shkojnë në gati 8.6 deri 9 miliardë lekë pasi kështu mendojmë që mbështesim në mënyrë të plotë skemat mbështetëse për të gjithë fermerët për të arritur në 100% të plotësimin të nevojave të tyre.

"Ne jemi në një plan pune në MBZHR për ta prezantuar në qeveri dhe kjo mbetet për buxhetin afatmesëm për diskutim. Është shumë e rëndësishme për ne, që skemat të nxisin prodhimin, produktivitetin dhe jo vetëm formal-

izimin. Skemat mbështetëse në këto vite kanë ndihmuar ndjeshëm formalizimin e ekonomisë megjithatë ne synojmë të shkojmë më tej drejt fiskalizimit të ndërmarrjeve dhe fermave tona bujqësore dhe për këtë binomilësi dhe shkallë është ajo që motivon bashkimin e operatorëve, ndaj dhe skemat nacionale vitin e ardhshëm do të shtojnë vëmendjen në bashkimin e operatorëve sepse kështu do të tejkalojmë disa nga problematikat si fragmentimi i tokës, etj, me të cilat ballafaqohet çdo ditë", deklaroi Denaj.

Ministrja tha se, "skemat nacionale vitin që vjen janë baza kryesore e mbështetjes së drejtpërdrejtë, ne kemi rialokuar në këtë projektbuxhet një shumë nga mbështetja për IPARD 3, që do të shkojnë në investime në infrastrukturë dhe vepra mbështetëse në bujqësi".

Denaj dhe Balla në shkollën bujqësore "Rakip Kryeziu": Përgatiten profesionistët e rinj të bujqësisë

Në shkollën e mesme bujqësore "Rakip Kryeziu", çdo vit përgatiten profesionistët e rinj të bujqësisë shqiptare.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e shoqëruar nga ministri i Brendshëm, Taulant Balla dhe zëvendësministrja e Financave dhe Ekonomisë, Olta Manjani vizituan këtë shkollë, ku u njohën nga afër me punimet që po kryhen për rikonstrukcionin total të saj në mënyrë që nxënësit të kenë kushte bashkëkohore për mësim.

Në këtë shkollë po zbatohet një projekt i përbashkët me qeverinë italiane, ku krahas rikonstrukcionit të shkollës dhe ambienteve të konviktit, po kryhet edhe trajnimi i mësuesve dhe ndryshimi i kurikulave dhe përafrimi i tyre me kërkesat e biznesit.

Aktualisht ka përfunduar puna për rikonstrukcionin e godinës së shkollës dhe konviktit dhe po punohet për riparimin e bazës prodhuese dhe furnizimit me laboratorë.

Ministrja Denaj në fjalën e saj u ndal në rëndësinë e të zgjedhurit të arsimit profesional.

"Mund të sigurojnë vendin e punës që vitin e parë që mbarojnë arsimin e mesëm katërvjeçarë, ndërsa pagat që ofrohen janë të larta. Kushtet në të gjitha shkollat profesionale po përmirësohen", tha Denaj.

Nga ana tjetër, ajo vuri në

dukje rëndësinë e shtimit të kapaciteteve të konvikteve për t'iu përgjigjur edhe kërkesave të të rinjve nga qarqet përreth.

Qeveria po punon për pro-

punës.

Me anë të këtij procesi u arrit në konkluzionin se 6 në 10 nxënës të arsimit profesional punësohen para diplomimit.



movimin e arsimit profesional si një rrugëtim tërheqës edukimi dhe karriere. Shanset e një nxënësi që përfundon arsimin profesional krahasuar me një moshatar që zgjedh shkollat e mesme të përgjithshme janë disa herë më të larta për punësim.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive mbështetjen e projektit Aftësi për Punë (S4J) realizoi gjurmimin në nivel kombëtar të të diplomuarve e certifikuarve në arsim dhe formim profesional.

Përmes gjurmimit u arrit të sigurohej vlerësimi i cilësisë së arsimit e formimit profesional duke mundësuar lidhjen e aftësive me kërkesat e tregut të

Projekte madhore si ndërtimi i aeroportit të Vlorës, apo hapja e disa fabrikave që prodhojnë sisteme kabllore apo pjesë të tjera për makinat në vendin tonë, ashtu si dhe investimet e mëdha në sektorin e hidrokarbureve kërkojnë punonjësit të kualifikuar.

Të dhënat tregojnë se mbi 57% e punëkërkuarve me arsim profesional hyjnë në punë që vitin e parë, pas përfundimit të edukimit.

Në 35 shkollat profesionale në të gjithë vendin janë përfshirë 22 drejtime mësimore, 87 profile profesionale kryesisht në hoteleri-turizëm, shkenca kompjuterike, shkenca mekanike, tekstile, etj.

PROJEKT/ BUXHETI 2024 PËR MINISTRINË E BUJQËSISË

KASH PARASHTRON DISA SUGJERIME DHE PROPOZIME PËR PROJEKT/ BUXHETIN, REFERUAR FONDIT TOTAL TË SHPENZIMEVE ADRESUAR PROGRAMEVE, DUKE E KRAHASUAR ME BUXHETIN E VITIT 2023

Sipas KASH, qeveria ka programuar për Ministrinë e Bujqësisë për vitin 2024 krahasuar me shpenzimet e miratuara për vitin 2023, të ulë me 11.6% totalin e buxhetit të shpenzimeve; të ulë investimet e huaja dhe të brendshme në masën 28.8% dhe të rrisë pagat në nivelin 28.4%

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar ka kundërshtuar projekt/ buxhetin e vitit 2024 për fondet e vëna në dispozicion të sektorit bujqësor.

Projekt/ buxheti i vitit 2024 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i miratuar në parim në parlament, është në shumën e afro 14.18 miliard lekëve, 11.6% më i ulët se buxheti i vitit 2023.

Sipas vlerësimit të situatës nga terreni KASH parashikon që mangësitë e programit të shpenzimeve do të ndikojnë negativisht në zhvillimin e zonave rurale në disa drejtime kryesore, siç është humbja e konkurrueshmërisë së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, rritja e çmimeve për konsumatorë, rritja e kostove për fermerët në raport me mallrat e importit, mbështetja më të ulët për skemën e naf-tës si dhe nxitja e mëtejshme të shpopullimit dhe lëvizjes së fuqisë punëtore aktive nga zonat rurale.

Totali i Programeve të P/ buxhetit për MBZHR në vitin 2024 (në milion/lekë) janë programuar 14.180.500 (katërm-bëdhjetë miliard njëqind e tetëdhjetë milion e pesëqind mijë) lekë, shumë që e shprehur në euro konvertuar me kursin 105 lekë/euro = me 135 milion euro, ose e shprehur në % është = me 1.9% e buxhetit aktual të shpenzimeve.

P/buxheti i programuar për vitin 2024 në total është më i vogël nga ai i miratuar në parlament për vitin 2023, për shumën 1 867 332 (një miliard tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e treqind e tridhjetë e dy mijë) lekë, shprehur në % me -11.6%, i shprehur në euro me kursin 105 lekë/euro, me -18 milion euro më pak nga viti 2023. Ulja e buxhetit reflektohet ndjeshëm veçanërisht në të dy zërat e investimeve si ato të brendshme dhe të huaja:

a) Investime të brendshme në 2023 janë miratuar në parlament 3 169 272 (tre miliard 169 milion e 272 mijë) lekë. Konvertuar në euro me kursin 105 lekë/euro = 30.2 milion euro. **Investime të brendshme në 2024** janë programuar në p/buxhet 2 827 272 (dy miliard 827 milion 272 mijë) lekë konvertuar në euro 26.9 milion

euro, me -3.3 milion euro, ose -10.8% më pak investime të brendshme.

b) Investimet e huaja në 2023 janë miratuar në parlament 3 660 260 (tre miliard gjashtëqind e gjashtëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Konvertuar në euro me kursin 105 lekë/euro = 34.9 milion euro. **Investimet e huaja në vitin 2024** janë programuar në P/buxhet 3 002 574 (tre miliard dy milion e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë)



lekë. Konvertuar me euro = 28.6 milion euro me -6.3 milion euro ose më pak -18% investime të huaja.

Duke i analizuar me radhë zërat e programit të shpenzimeve për p/buxhetin, referuar strukturës së hartimit të buxhetit të MBZHR, për vitin 2024 i krahasuar me atë të miratuar për vitin 2023 na rezultojnë se:

Programi: Planifikim, Menaxhim, Administrim:

Zëri Investime të brendshme është miratuar për vitin 2023, shuma 7 000 (shtatë milion) lekë. Për vitin 2024 janë programuar 5 000 (pese milion) lekë, dy milion lekë më pak dy ose -28.6%.

Programi: Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit:

Zëri Investime të brendshme për vitin 2023 janë miratuar në shumën 275 409 (275 milion e 409 mijë) lekë. Investime të brendshme në vitin 2024 janë programuar 95 409 (95 milion e 409 mijë) lekë më pak -180 milion lek ose -55.4%.

Programi: Zhvillimit Rural rezultojnë me uljen më të madhe në P/buxhetin e vitit 2024: **Zhvillimit Rural në buxhetin e vitit 2023** i janë miratuar 10.493.771 lekë (dhjetë miliard 493 milion e 771 mijë) lekë. **Zhvillimit Rural në vitin 2024** i janë programuar 7 247 794 lekë (shtatë miliard 247 milion e 794 mijë) lekë më pak 3 145 977 (tre miliard 145 milion e 977 mijë) lekë ose -30% krahasuar me vitin 2023. Programi i buxhetit për Zhvillim Rural, duhet theksuar fakti se përveç të tjerave përf-

shin edhe katër nga zërat me shumë rëndësi për fermerët dhe subjektet që punojnë në zonat rurale si:

a) SKEMËN e MBËSHTETJES KOMBËTARE

për bujqësinë, me grante nga buxheti i shtetit, që në vitin 2023 është miratuar në shumën 3 785 000 (tre miliard 785 milion) lekë. Në P/buxhetin e vitit 2024 është programuar në shumën 2 071 000 (dy miliard e 71 milion) lekë, më pak 1.714 000 (një miliard 714 milion) lekë ose -45.3% më pak.

b) INVESTIME TË BRENDSHME

në buxhetin e vitit 2023 i janë miratuar 1 601 863 (një miliard 601 milion 863 mijë) lekë. Në P/ buxhetin e vitit 2024 i janë programuar 1 016 863 (një miliard 16 milion e 863 mijë) lekë me një diferencë më pak prej 585 milion lekë ose -36.5% më pak.

c) INVESTIME TË HUAJA

në vitin 2023 i janë miratuar 3.329.308 (tre miliard 329 milion e 308

mijë) lekë në P/buxhetin e vitit 2024 i janë programuar 2 229 151 (dy miliard 229 milion e 151 mijë) lekë, më pak 1 100 157 lekë (një miliard 100 milion e 157 mijë) lekë ose -33% më pak.

d) Nafta falas për fermerët

për vitin 2024 është programuar në të njëjtat nivele me vitin 2023 në shumën fillestare të miratuar prej 1.328.000 (një miliard treqind e njëzet e tetë) million lekë. Por duke e krahasuar me shtesën që është bërë nga parlamenti me aktin e fundit normativ edhe ky zëri i programit është më i vogël se ai i vitit 2023.

Programi: shpenzimeve i vitit 2024 vetëm në tre zërat në vijim nuk janë programuar ulje shpenzimesh krahasuar me programin e



miratuar për vitin 2023 janë:

a) Këshillimi dhe informacioni bujqësor dhe shkenca ka një rritje me +38%
b) Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore nuk ka rritje +0%
c) Menaxhimi i peshkimit ka një rritje prej +17.3%
Qeveria ka programuar për MBZHR për vitin 2024 krahasuar me shpenzimet e miratuara për vitin 2023:

Të ulë në total buxhetin e shpenzimeve të MBZHR në masën -11.6%.

Të ulë investimet e huaja dhe të brendshme në masën -28.8%.

Të rrisë pagat në masën +28.4%.

Sipas vlerësimit të situatës nga terreni, KASH parashikon që mangësitë e programit të shpenzimeve sa më sipër do të ndikojnë negativisht në të ardhmen për zhvillimin e zonave rurale të vendit tonë në disa

drejtime kryesore:

Prodhimet bujqësore dhe blegtorale nuk do të jenë konkurruese, si në rajon dhe më gjerë. Çmimet e tyre për konsumatorët nuk do të ulen por do të rriten.

Kostua e prodhimeve të fermerëve dhe subjekteve të vendit, që punojnë në zonat rurale do të rezultojnë më të larta krahasuar me mallrat që do të vijnë nga importi.

Procesi i certifikimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, përpunimi i mbetjeve në zonat rurale, ulja e firove dhe skarcitetit, si dhe rritja e prodhimeve organike do të ngadalësohet.

Tregjet bujqësore dhe blegtorale nuk do të mbështeten për të plotësuar edhe standardet dhe kërkesat minimale të veprimtarisë së tyre.

9.45 miliard lekë ose 90 milion euro të ndara sipas programeve:

Programi i shpenzimeve për infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit për vitin 2024 është i pamjaftueshëm. Krahasuar me financimin e shpenzimeve të programuara në strategjinë kombëtare të ujitjes dhe kullimit 2019-2030, të cilën nuk e kemi realizuar as 60% deri tani.

Nevojat minimale për vitin 2024 për këtë zëri të programit të shpenzimeve janë edhe për 500 milion lekë më shumë nga sa janë programuar në draftin e buxhetit të vitit 2024.

Programit të Zhvillimit Rural për të plotësuar nevojat minimale në të gjitha zërat për vitin 2024 i duhen shtuar edhe 6.5 miliard lekë.

Programit Siguria Ushqimore për të përballuar emergjencat i duhen shtuar edhe 2 miliard lekë

Programit të Mbështetjes për Peshkimin dhe akuakulturën i duhen shtuar edhe 500 milion lekë.

Shpenzimet shtesë duhen për të përballuar nevojat më minimale të detyrimeve institucionale që MBZHR ka ndaj sektorit privat, por edhe nga pasojat negative që i vijnë sektorit nga disa faktorë negativë, që për periudhën në vijim parashikohen më të përkeqësuar nga:

Ngrijja e procedurave të disbursimit të fondeve IPARD III, Inflacioni dhe konjunktura e pafavorshme e çmimeve të import-eksportit në tregun ndërkombëtar,

Pasojat e luftës në Ukrainë dhe së fundi në Lindjen e Mesme,

Pasojat negative nga përkeqësimi i kushteve atmosferike, Mungesa e mbështetjes nga shoqëritë e siguracioneve të subjekteve që operojnë në zonat rurale,

Niveli i pamjaftueshëm i kreditimit nga bankat e nivelit të dytë,

Plotësimi i kërkesave në procesin e negociatave për integrimin në BE, etj.

MBZHR i duhen shtuar në buxhet në zërat e mësipërm të Programit të shpenzimeve për vitin 2024 edhe 9.45 miliard lekë ose rreth 90 milion euro.

KASH i sugjeron Parlamentit që në buxhetin e shpenzimeve të vitit 2024 MBZHR minimalisht i duhen shtuar edhe 9.45 miliard lekë ose 90 milion euro të ndara sipas programeve.

Shpenzimet shtesë duhen për të përballuar nevojat më minimale të detyrimeve institucionale që MBZHR ka ndaj sektorit privat, por edhe nga pasojat negative që i vijnë sektorit nga disa faktorë negativë, që për periudhën në vijim parashikohen më të përkeqësuar.

Denaj me fermerët në Fier: Të realizojmë bashkimin e operatorëve për të dalë në tregjet ndërkombëtare

Fieri është një nga rajonet me potencialin më të lartë të zhvillimit të bujqësisë në vendin tonë dhe nxitja e modelit të bashkimit të operatorëve shihet si instrumenti i duhur në rritjen e shkallës, cilësisë, eksporteve dhe të ardhurave për familjet e fermerëve dhe ekonominë e vendit.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, e shoqëruar nga ministri i Brendshëm Taulant Balla, kryetari i Bashkisë Armand Subashi zv.ministria e Financave dhe Ekonomisë Olta Manjani, deputet të zonës dhe përfaqësues nga institucionet e linjës, zhvilluan një takim me fermerët dhe sipërmarrës të bujqësisë në zonën e Fierit.

Denaj diskutoi me fermerët për ecurinë e punës në bujqësi, nevojat që kanë produktet për më shumë cilësinë, teksta vuri në dukje rëndësinë për të kaluar nga prodhimi në shkallë të vogël, në një shkallë të mesme në fillim dhe pastaj në një shkallë më të madhe.

“Do jap disa shifra për të kuptuar se sa potencial ka ende në këtë zonë. Flasin për gati 87 mijë ha sipërfaqe toke të punueshme, 21 mijë ha drufrutor, 1 100 ha serra dhe 84 mijë fermerë nga të cilët 30 mijë janë të pajisur me NIPT”, tha Denaj.

Ministria shprehu angazhimin dhe mbështetjen, për të nxitur bashkimin e operatorëve në sektorin e bujqësisë, si faktor kyç në rritjen e ekonomisë së shkallës dhe mbështetjen e fermerëve përmes Skemës Kombëtare.

“Kemi nisur një projekt së bashku me kryetarin dhe pushteti vendor do të na ndihmojë për bashkimin e operatorëve, në një interes ekonomik të përbashkët që zhvillon shkallën dhe cilësinë. Ne do bëjmë de tytrat tona, duke ju dhënë instrumentat e duhura, por duhet edhe përpjekja juaj që në këtë bashkim interesash, ju të bëhe-

ni bashkë, që të keni mundësi për më shumë sipërfaqe toke që prodhon të njëjtin produkt dhe me të njëjtin cilësi që kërkon tregu ndërkombëtar dhe të bëjmë certifikimet e duhura”, tha Denaj.

Ministria u ndal në krijimin e fermave organike dhe rëndësinë e certifikimit të prodhimit bujqësor me Global Gap, që është një ‘pasaportë’ për eksportet e produkteve “made in Albania”.

Global GAP, është një produkt certifikimi sipas standardeve ndërkombëtare. Global GAP në Shqipëri ndodh përditë, përvit dhe Skema Kombëtare mbështet kostot për certifikimin global GAP.

Denaj ftoi fermerët të bashkohen për të arritur kërkesën që kërkon certifikimi Global GAP, pasi në sipërfaqe të vogël nuk arrihen të realizohen dot të gjitha kërkesat.

“Në këtë qark ka 92 ferma organike. Kërkesa jonë së bashku me ju dhe me punën në vijim, është si ta çojmë që të gjithë përfitimin e skemës për produktet organike, ku tregjet ndërkombëtare sot sidomos Gjermania, Franca, Zvicra etj e kërkojnë, e ta kemi të plotë. Këto tregje kanë mundësi ta përthithin produktin organik të vendit tonë që ka kushtet klimatike, që favorizon një produkt të mirë, cilësor dhe të ketë vlerë, sepse një produkt organik shitet më shtrenjtë”, u shpreh ministria.

“Është shumë e rëndësishme të dëgjojmë problematikat dhe të përfshijmë të gjithë institucionet e linjës për të bërë realitet, bashkimin e operatorëve si rrugën e duhur për të shkuar në tregjet ndërkombëtare, të gjithë bashkë e me të njëjtin interes”, theksoi ministria Denaj.

Ministri i Brendshëm Taulant Balla, gjatë fjalës së tij, vuri theksin në hartimin e një strategjie të re për vaditjen e tokave bujqësore, që i vjen në mbështetje fermerëve dhe zh-

villimit të sektorit.

Balla, duke marrë fjalën si deputet i zonës, tha se, “për të gjithë qarkun e Fierit nga Lushnja, Divjaka e deri tek Rroskoveci, Patosi dhe Mallakastra, gjëja kryesore që duhet të mendoj MBZHR, jo për sot por për atë që themi Shqipëria 2030, na duhet një strategji e re për vaditjen”.

“Ne mund të bëjmë shumë gjëra por pa ujin nuk bëjmë dot asgjë. Shqetësimi im gjatë vitit të kaluar që pati temperatura shumë të larta, ishte se në shumë zona nuk morën prodhimin që duhej të merrnin sepse, nuk arritëm që t’i japim ujë në vaditje që kishte nevojë toka”, tha Balla.

Balla vuri theksin në agazhimin e qeverisë për të mbështetur të gjithë fermerët aplikantë në skemën e naftës pa taksa për bujqësinë.

“Ne kemi patur në Fier aplikime në skemën kombëtare vetëm për skemën e naftës plotë 18 mijë 836 fermerë aplikantë dhe nga vlerësimi rezultoi se janë 16 mijë 945 aplikime që përmbushnin kriteret dhe çfarë ishte parashikuar me buxhetin e vitit 2023, u arrit të jepej nafta për 10 mijë e 800 përfitues. Por u arrit që ne të bënim një Akt Normativ, i cili edhe pse me tym dhe me ata që hedhin karriget, se populli të sheh dhe kur sheh që ata nuk e duan karrigen që u ka besuar populli, mos e jep më, dhe me gjithë kushtet e vështira të Shqipërisë, Akti Normativ ka hyr në fuqi dhe lajmi i mirë është që edhe 6 mijë 142 fermerë të tjerë, do të marrin dhe ata naftën pa taksa”, u shpreh Balla.

Balla tha se, edhe për vitin e ardhshëm jo vetëm që do ta ruajmë këtë rezultat por dhe do ta shtojmë mbështetjen për fermerët dhe bujqësinë.

Ndërsa zv.ministria e Financave dhe Ekonomisë Olta Manjani, u ndal në rëndësinë e arsimit profesional si rruga e duhur për punësimin e të rinjve.

Dëftesat tregtare, gati projekti. Qeveria kërkon të zgjidhë problemet e fermerëve

Një dëftesë tregtare bujqësore që e gjen të gatshme në portalin e-Albania dhe më pas një regjistër i këtyre dëftesave që krijohet për herë të parë dhe financohet nga Sekretariati Ekonomik i Zvicrës, do të jenë zgjidhja që i afrohet fermerëve shqiptarë për zgjidhjen e problematikave të deritanishme.

Kryesore është pamundësia e fermerëve për të marrë financime apo vështirësitë për të përfituar kredi bujqësore, të cilat, në këtë fushë, konsiderohen me risk të lartë nga ana e bankave. Edhe përdorimi i produkteve bujqësore si kolateral është i pamundur. Njëlloj si toka bujqësore, e cila nuk është e mundur të përdoret si kolateral, si pasojë e mungesës së dokumentacionit të pronësisë.

Po njëjtë, fermerët vuajnë edhe një marrëdhënie shit-blerje mes fermerit dhe një blerësi, i cili paraprakisht hyn garant për të blerë produktin e ardhshëm bujqësor që do kultivojë/prodhojë fermeri. Në mungesë të një ligji që ofron mbrojtje për fermerin është provuar se shpesh blerësi abuzon me pozicionin e tij në mënyrë që të ulë çmimin real.

Qeveria ka paraqitur një projektligj, për herë të parë, që

siguron që me instrumente financiare alternative të krijohet një qasje e re, ku fermerëve u krijohet një mundësi për financime si përmes sistemit bankar



apo/edhe si hallkë e zinxhirit bujqësor të vlerave. Ligji i ri përdor produktin bujqësor, në magazinë apo në prodhim e sipër, të mund të përdoret si kolateral.

Sipas autoriteteve synimi është pajisja e fermerët me dëftesën tregtare, me qëllim përfitimin e kredive bankare më përqindje më të ulët, brenda një afati 3-vjeçar.

Qeveria sqaron se kosto ekonomike është krijimi i regjistrit të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore në

platformën e-Albania, ndërsa shpenzimet për këtë janë marrë përsipër të mbështeten nga projekti SECO (Sekretariati Ekonomik i Zvicrës) për një



periudhë 3-vjeçare nga momenti i krijimit dhe funksionimit të tyre.

Sektori privat, pra fermerët shqiptarë nuk kanë kosto, pasi edhe lëshimi i dëftesave tregtare online, nëpërmjet modulit të dedikuar në platformën e-Albania do të jetë pa pagesë.

Nëpërmjet këtij ligji parashikohet të aplikohen çmime më të arsyeshme për konsumatorin, si dhe produkte bujqësore më të kontrolluara dhe më cilësore, përfshirë edhe rritjen e të ardhurave për familjet bujqësore.

Mbështetje për zhvillimin e qendrave mikro-ushqimore - Kredi 64,6 milionë euro për qëndrueshmërinë ndaj klimës dhe zhvillimin e bujqësisë

Një kredi me vlerë 64,6 milionë euro nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka për qëllim të rrisë konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë klimatike të zinxhirëve prioritarë agroushqimorë, të vlerës nëpërmjet ndërhyrjeve në promovimin e bujqësisë inteligjente klimatike dhe aksesit në tregje.

Gjithashtu, synohet rritja e standardeve të sigurisë dhe

ofruar akses më të mirë në treg për prodhuesit vendas, duke mbështetur zinxhirët e shkurtër të furnizimit dhe elasticitetin në furnizimin e zonave urbane me ushqim

Synohet zhvillimi i grupeve tipike të produkteve ushqimore, apo zinxhirëve të vlerës në zona të caktuara me qëllim investimin në drejtim të shtimit të vlerës së produktit, apo transformimin e tij si

bujqësore.

Një vëmendje të shtuar merr edhe fuqizimi i skemave të ujitjes dhe të kullimit në zonat me bujqësi intensive dhe kultivim të kultivarëve me vlerë të lartë. Konkretisht do të investohet në skemën ujëtse të Mursisë dhe Divjakës, në skemat alternative për ujitjen në Bashkinë Lushnjë, si dhe modernizimin e sistemeve të kullimit.

Pjesë e financimit do të jetë mbështetja për laboratorët e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe pikave të inspektimit kufitar. Kjo do të arrihet nëpërmjet rritjes së kapacitetit institucional për të kryer kontrole zyrtare për kafshët e gjalla, produktet me origjinë shtazore dhe joshtazore, bimët dhe produktet bimore, si dhe inputet bujqësore, përmirësimin e kapaciteteve inspektuese dhe mbështetjes diagnostike në fushën e sigurisë ushqimore. Ndërkohë, do të zhvillohet kapaciteti i ruajtjes së produkteve përmes ndërtimit të objekteve të magazinimit dhe blerjes së pajisjeve.

Marrëveshje e kredisë me vlerë 64,6 milionë euro nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) është dërguar për miratim në Kuvend.



cilësisë së ushqimit, si dhe forcimi i kapaciteteve të analizave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Nëpërmjet këtij financimi pritet mbështetje më e madhe për zhvillimin e qendrave mikro-ushqimore në zonat periferike të qyteteve kryesore në rajonet e përzgjedhura për të

dhe zhvillimi i një platforme informative për bujqësinë inovative klimatike për të mbledhur të gjithë informacionin përkatës, si llojin e tokës, të dhënat hidrometeorologjike, sensorë për lagështinë e tokës, praktikatat bujqësore dhe për të drejtuar fermerët drejt adoptimit të praktikave elastike

Masat për dimërimin e kafshëve, me rëndësi baza ushqimore dhe vaksinimi

Qarku i Korçës shoqërohet me dimër të ftohtë e të gjatë, ndaj blegtorëve u duhet të marrin një sërë masash për dimërimin e kafshëve që mbarështojnë.

Kryesore është që u duhet të sigurojnë sasi të bollshme të rezervave ushqimore për kafshët, si dhe përgatitja e stallave me kushtet e duhura për mbajtjen e kafshëve

“Të rishikohet inventari i bazës ushqimore për dimërimin meqenëse zona e Korçës është kryesisht malore dhe me dimër të ashpër,” tregon Lazzart Suraj, përgjegjës i sektorit

të punës racore në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Korçë.

Përgjegjësi i Sektorit të punës racore në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore dhe Blegtorale Lazzart Suraj shton më tej se tepër e rëndësishme është që të kryhet vaksinimi i bagëtive të imta kundër një sërë sëmundjesh në mënyrë që gjendja shëndetësore e kafshëve të jetë sa më e mirë si dhe të mos kenë humbje të krerëve.

“Tek dhentë duhet të kryhet vaksinimi kundër sëmundjeve që shkakton dështime, siç është

salmoneloza apo që në gjuhën popullore quhet paratifo. Në drejtorinë tonë janë ezauruar një pjesë e mirë e këtyre masave profilaktiko-veterinare, por edhe nga ana higjieno-sanitare, këto momente teknike e praktike janë realizuar,” shpjegon z. Suraj.

Sëmundjet infektive dhe parazitare prej vitesh nuk i kanë prekur në masë bagëtitë që mbarështohen në Qarkun e Korçës, kjo si rezultat i shërbimit të rregullt veterinar të kryer, duke bërë që tufat që mbarështojnë blegtoret të jenë të pastra.

SIPËRMARRËSET

Zëri i grave sipërmarrëse në bujqësi

Gratë në zonat rurale ofrojnë ushqim për komunitetet e tyre dhe forcojnë ekonominë. Në Shqipëri punojnë me përkushtim për të rigjallëruar ekonominë vendase.

Përmes një mesazhi sensibilizues dhe ndërgjegjësues, gazeta Agrobiznesi synon të ndihmojë dhe kontribuojë në fuqizimin e grave në zonat rurale dhe turizmit.

“Këtu rreh zemra e vendit tonë. Një vend pune për disa dhe një shtëpi për shumë të tjerë. Këtu ku peisazhet e fushave të mbjella dhe të shtëpive mikpritëse takohen me malet dhe kodrat e ndriçuara nga dielli.

Komunitetet tona rurale janë të veçanta, sepse gratë i bëjnë ato të tilla.

Ato janë të guximshme dhe me guxim po krijojnë një shoqëri me mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, ku sfidat dhe vështirësitë kalohen bashkë dhe një sensi të përbashkëtës dhe komunitares ndihet kudo. Çdo ditë ato kultivojnë, për-punojnë dhe përgatisin ushqime të shëndetshme për të gjithë.

Është koha të reflektojmë për mirëqenien e grave në zonat

rurale dhe të krijojmë një mjedis fuqizues me mundësi që hapin derën e zhvillimit të ekonomisë.

Ato janë kampione të ushqimit dhe punojnë me përkushtim për të rritur komunitetet lokale dhe për t'i dhënë formë të ardhmes së tyre. Komunitetet tona janë të çmuara, është koha që ta riimagjinojmë të ardhmen rurale për një shoqëri, mjedis dhe ekonomi më të qëndrueshme, me mundësi dhe të drejta të barabarta për të gjithë”.

Është ky mesazhi, kolazh që përcjell zërin e grave që punojnë në bujqësi dhe kanë ngritur sipërmarrje model në llojin e tyre, që shërbejnë si shembuj për tu ndjekur dhe për tu mbështetur më tej.

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) agazhohet të jetë një zëmë shumë në krah të politikëbërësve për të mbështetur këto sipërmarrëse të guximshme të ngjisin shkallët e biznesit çdo ditë e më lart, për të ndërtuar së bashku një bujqësi të qëndrueshme.

Nga viti në vit është rritur numri i femrave aplikante në skemat mbështetëse dhe programin IPARD. Rreth 15% më

shumë fermere dhe sipërmarrëse kanë aplikuar në vitin 2022 në Skemën Kombëtare, ndërsa në programin IPARD janë lidhur 39 kontrata me fermere gra deri më tani. Mbështetja vazhdon. Sipas studimit, Gratë përballen me kufizime, sidomos kur përpiqen për mobilizimin e kapitalit për zgjerimin ose diversifikimin e biznesit të tyre. Sa i përket qasjes në kredi dhe burimeve të tjera financiare, gratë sipërmarrëse kanë të drejta të barabarta në lidhje me kreditimin e tyre nga institucionet financiare. Studiimi rekomandon:

- BSH dhe MF duhet të inkurajojë institucionet financiare të zhvillojnë shërbime të përkushtuara dhe të ngrenë objektiva për gratë sipërmarrëse të orientuara drejt rritjes.

- Ministria e Ekonomisë të mbështesë zhvillimin e programeve të përshtatura për rritjen e ndërmarrjeve me pronare gra, që do të përfshijnë lidhjen me fonde publike

Sipas BSH-së, gratë pronare të biznesit, marrin hua 12,2% të vlerës së përgjithshme të kredive, dhe numri kredive, 31,4% gjithsej janë marrë nga gratë.

Fermere, qeveria me skemë të re financimi për bizneset e vogla në bujqësi

Qeveria ka hedhur për shqyrtim në publik një projektligj, që lidhet me dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore. Qëllimi i këtij projektligji është që të sigurojë sa më shumë financime në bujqësi, pagesa të shpejta dhe të drejta për fermerin për produktin bujqësor të ardhshëm dhe atë të magazinuar, si dhe krijimin e një sistemi kolaterali nëpërmjet produktit bujqësor të ardhshëm dhe atij të magazinuar.

Në këtë projektligj rregullohen në mënyrë specifike dy instrumentet financiare si “dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm” dhe “dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar”, procedura elektronike e lëshimit të këtyre dëftesave, regjistrimi i tyre në formë elektronike, si dhe në regjistrin e barëve siguruese, shkruan rtsh.al.

Rritja e financimeve

Me anë të këtij projektligji, që sillet në vëmendje nga rtsh.al, synohet që të rriten financimet në bujqësi; fermerët të nxiten të kultivojnë dhe të prodhojnë sa më shumë produkte bujqësore; një financim paraprak për fermerin, si dhe garantim i kreditorit për t'u paguar në lekë apo në natyrë, me produktin bujqësor të ardhshëm; rregullim juridik i marrëdhënies mes fermerit dhe grumbulluesit të produkteve bujqësore, duke mundësuar që fermeri të paguhet për produktin, që në çastin e grumbullimit apo në një moment më të vonë, kur çmimi i shitjes së produkteve të jetë më i lartë.

Pra, synohet krijimi i një zinxhiri financimi më të mirë për subjektet e përfshira në sektorin bujqësor.

Përvoja botërore

Ky projektligj hartohet për

herë të parë në vendin tonë. Në vendet e tjera ka një traditë të konsoliduar në lidhje me këto instrumente financiare mbi produktet bujqësore.

Në rastin konkret janë marrë në konsideratë traditat ligjore të krijuara për të rregulluar këto marrëdhënie juridike në Brazil, Ukrainë, etj.

Në këto shtete fermerët e vegjël janë përballur me problematikën e pamundësisë për të marrë kredi duke përdorur produktin bujqësor si kolateral dhe aty e ka gjenezën thelbi i projektligjit të propozuar.

Kështu në Brazil, që në vitet '60 u miratua koncepti i “premtimit për të paguar” (Promisory Note) si mënyrë e financimit të bujqësisë, përpara vjeljes së produktit dhe pas magazinimit të produkteve bujqësore.

Fillimisht kjo mënyrë financimi u përdor nga bankat, të cilat mbështeteshin nga qeveria për të financuar fermerët.

Me rënien e mbështetjes financiare nga qeveria u gjetën alternativa të tjera të financimeve private dhe në vitin 1994 u miratua në Brazil instrumenti i ri “Cedula de Produto Rural” (CPR) që janë titujt mbi produktin rural, si mënyrë financimi në bujqësi mënyrë e cila solli hov në zhvillimin e bujqësisë në këtë shtet.

Po ashtu në Ukrainë një ligj i ngjashëm është miratuar në vitin 2012, bazuar në modelin e sukseshëm të Brazilit dhe si mënyrë për të ndihmuar me financime fermerët e mesëm dhe të vegjël.

Rezultati në Ukrainë ishte që në gjashtë vite mbi 3500 fermerë lëshuan mbi 7100 titujt mbi produktet bujqësore dhe tejkaluan mbi 1.7 miliardë dollarë financime.

Kostot dhe fermerët

Gjatë procesit të hartimit të këtij projektligji, në vendin tonë është punuar paralelisht dhe në bashkëpunim me ekipet e ngritura në shtetet fqinje për hartimin e të njëjtin ligj si në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, duke synuar një rregullim juridik gati të njëjtë, për instrumentet financiare mbi produktet bujqësore, në të tre vendet.

Projektligji është modern dhe praktik, pa kosto të shtuara për fermerët apo subjektet e tjera të përfshira, si: grumbulluesit, eksportuesit, agropëpunuesit, furnizuesit e lëndëve të para, investitorët, etj.

Procedura për lëshimin e këtyre dëftesave tregtare është parashikuar të jetë elektronike, në platformën shtetërore e-Albania, pa tarifa, duke kryer në të njëjtën kohë online edhe regjistrimin si barrë siguruese të këtyre dëftesave.

Efektet primare që pritet të sjellë në zbatim ky projektligj do të jetë shtimi i financimit në bujqësi, rritja e sipërfaqes së kultivuar në vend, rritja e ndjeshmërisë dhe përmirësimi të cilësisë së produkteve bujqësore, një funksionim më i mirë i gjithë zinxhirit të produkteve bujqësore, që nga çasti i mbjelljes së fidanëve/ farave e deri në çastin e shitjes apo përpunimit të produkteve bujqësore.

Si efekt indirekt pritet që projektligji të ndikojë për mirë duke shmangur problemin e shkaktuar deri tani nga copëzimi i skajshëm i tokës bujqësore. Pra 3 efektet e pritshme pozitive janë të shumta me impakt në rritjen ekonomike në sektorin e bujqësisë, rritje të mirëqenies së fermerëve, si dhe të subjekteve të tjera, të përfshira në këtë sektor.



Me zgjidhje dhe instrumenta për sigurinë e informacionit dhe sigurinë kibernetike të kompanive, skuadra e këtij start-upi do të marrë pjesë në konkursin final të Women Startup Competition Europe në Vjenë, gjatë muajit dhjetor.

Çmimi i dytë shkojë për Smart Kids, një metodologji edukimi

Zhvillohet në Tiranë Women Startup Competition Albania 2023. Cyber Morfosis, start-upi fitues

në Europë House, 10 startupe, që drejtohen nga gratë dhe vajza shqiptare, por që erdhën nga Shqipëria, Italia, Gjermania

rimin për t'i prezantuar ato në Tiranë, por u nevojitet mbështetje në konsulencë dhe financa, për të siguruar një biznes të qën-

FastCall dhe Adriatik Hotel.

Për një muaj, start-upet u mentoruan dhe trajnuan nga Albana Mucaj, ambasadore e WSC për

drejtuar nga gra dhe vajza. Konkursi final për Shqipërinë këtë vit u zhvillua me 10 Nëntor në Tiranë dhe start-upi fitues

Dudaj, në rolin e Advisory Board Member në New Haven University, në Amerikë, ofron 3 bursa studimi të skontuara 80% në "Women in Leadership Program of New Haven University".

Çmimi i parë konkuron në finalen europiane, Çmimi i dytë dhe i tretë do të mbështeten me



për të rinjtë dhe fëmijët përmes përdorimit të robotëve.

Ndërsa me çmimin e tretë u vlerësua start-upi shqiptar në fushën e turizmit Loc.al. Ai lindi në Gjermani dhe synon krijimin e një kompanie në zhvillimin e turizmit shqipfolës në Ballkan.

Gjatë eventit përmblyllës

nia dhe Holanda prezantuan zgjidhjet e tyre para një audience mbi 50 persona, sipërmarrës, drejtues të organizatave të ndryshme, dhe përfaqësues të institucioneve publike.

Albana Mucaj, ambasadore e WSC për Shqipërinë theksoi se, “grate janë të apasionuara pas ideve të tyre, sa të marrin flutu-

drueshëm dhe fitimprurës”.

10 start-upet u përzgjedhën mes 32 startupeve të trajnuara dhe të mentoruara nga qendra Kallz me mbështetjen e BERZH, Këshilla për Bizneset e Vogla, financuar nga EU – Western Balkans Enterprise Development & Innovation Facility (EDIF), Grupi Eurosig, INSIG, UBA Bank,

Shqipërinë, Landa Grembi, eksperte dhe mentore në fushën e startupeve, Nevila Dudaj, sipërmarrëse dhe Marjana Murja, eksperte në fushën e marketingut.

Ky është viti i dytë që Qendra Kallz përgatit start-upet për Konkursin e Women Startup Competition, duke përfshirë në trajnime 60 biznese të reja,

do të marrë pjesë në konkursin final të Women Startup Competition Europë në Vjenë në muajin Dhjetor.

Çmimi i parë konkuron në finalen europiane, Çmimi i dytë dhe i tretë do të mbështeten me strategji PR nga Qendra Kallz në 6 muajt e ardhshëm.

Për 3 fitueset, znj.Nevila

strategji PR nga Qendra Kallz në 6 muajt e ardhshëm.

Për 3 fitueset, znj. Nevila Dudaj, në rolin e Advisory Board Member në New Haven University, në Amerikë, ofron 3 bursa studimi të skontuara 80% në "Women in Leadership Program of New Haven University".

INFORMACIONE

Mete takim me ambasadoren Huber, stoku i investimeve zvicerane 2,021 milionë euro

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Ervin Mete, priti në një takim zyrtar ambasadoren e Zvicrës në Tiranë, Ruth Huber.

Qëllimi i takimit ishte diskutimi mbi marrëdhëniet ekonomike mes Shqipërisë dhe

vend të veçantë zë mbështetja për formimin profesional të të rinjve në vendin tonë.

Ministri shprehu interesin për të zgjeruar bashkëpunimin mes dy vendeve e në këtë drejtim një rol të rëndësishëm zë nxitja e bashkëpunimit institucional sa i

drejtim, Ministri tha se Shqipëria mirëpret biznesin zviceran për të shtuar prezencën e tij, në sektorë prioritarë të ekonomisë, si turizmi, energjia, etj.

Nga ana e saj, ambasadorja Huber shprehu angazhimin për të vijuar bashkëpunimin dhe për të forcuar marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve, si dhe për vijimin e një sërë projektsh që po zbatohen aktualisht me mbështetjen e qeverisë së Zvicrës.

Zvicra është një ndër investitorët kryesorë të drejtpërdrejtë në Shqipëri. Prezenca e stokut të investimeve zvicerane në vendin tonë është karakterizuar nga një trend rritës gjatë periudhës 2018-2022, duke arritur maksimumin në vitin 2022, përkatësisht në 1,876 milionë euro, me një rritje prej 7.4% krahasuar me vitin paraardhës.

Në qershor 2023, stoku i investimeve shënoi vlerën 2,021 milionë euro, duke e renditur Zvicrën të parën për stokun e investimeve të huaja në vend.

Aktualisht në Shqipëri operojnë rreth 88 biznese zvicerane me status aktiv, në fusha të ndryshme të ekonomisë.



Zvicrës, ku u theksua niveli shumë i mirë i bashkëpunimit dhe potenciali për thellimin e mëtejshëm.

Ministri Mete falënderoi ambasadoren Huber për mbështetjen që Zvicra jep për Shqipërinë në fusha të ndryshme të zhvillimit ekonomik, ku një

përket promovimit dhe tërheqjes së investimeve të huaja, si dhe në drejtim të nxitjes së eksporteve.

Ministri Mete bëri një prezantim të shkurtër të zhvillimeve më të fundit ekonomike në vendin tonë, ku theksoi se ekonomia e vendit po ecën në një trajektore pozitive. Në këtë

Situata në Gaza, Drejtori i Përgjithshëm i FAO-s, deklaratë mbi sigurinë ushqimore

Drejtori i Përgjithshëm i FAO, Qu Dongyu në një deklaratë për medien ka reaguar mbi situatën e sigurisë ushqimore në Gaza.

"Jam thellësisht i shqetësuar nga humbja e jetëve dhe katastrofën humanitare për shkak të dhunës që po ndodh në Lindjen e Mesme, dhe veçanërisht në Gaza.

në Izrael dhe Palestinë, vijoi ai, po ndikon në mënyrë drastike të gjitha dimensionet e sigurisë ushqimore. Edhe para përshkallëzimit, afro 60 për qind e familjeve në Gaza konsideroheshin të pasigurta në ushqim ose të cënueshme ndaj pasigurisë ushqimore. Aktivitetet bujqësore dhe agroushqimore në Gaza kanë rënë kryesisht që

partnerët tanë humanitar, FAO është plotësisht e përkushtuar për të adresuar nevojat urgjente humanitare të popullsisë në Rripin e Gazës dhe nevojat shtesë që shfaqen në Bregun Perëndimor për të mbrojtur dhe rivendosur jetesën e bazuar në bujqësi. Ne po e ndjekim situatën me shqetësim të madh dhe vazhdojmë të mobilizojmë ekspertizën teknike për të mbështetur popullin e Palestinës, duke përfshirë edhe bashkëudhëheqjen tonë të Clusterit të Sigurisë Ushqimore.

FAO po mobilizon furnizimet jetike të bujqësisë për transportin në Gaza pasi të vihen në dispozicion qasja dhe burimet. Përveç kësaj, FAO do të mbështesë vlerësimet e sektorit agroushqimor në terren sa më shpejt që të lejohet kushtet. Ne po monitorojmë gjithashtu ndikimin e armiqësive në sigurinë ushqimore në rajon dhe më gjerë", deklaroi Drejtori i Përgjithshëm i FAO, Qu Dongyu.

Dongyu, rikonfirmoi angazhimin e plotë të FAO-s për të vazhduar dhe për të rritur ndihmën për popullin palestinez, duke marrë të gjitha masat e nevojshme për ta bërë këtë brenda mandatit të FAO-s.

"Uji, ushqimi, ilaçet dhe furnizimi me karburant janë prioritetet urgjente dhe të vetëkuptueshme për të lehtësuar vuajtjet njerëzore, por nuk duhet të harrojmë rëndësinë e ndihmës urgjente bujqësore për mbijetesë", tha Dongyu.



Unë bashkohem me Sekretarin e Përgjithshëm dhe kolegët e mi në IASC me thirrjen për një armëpushim të menjëhershëm humanitar, për të lehtësuar vuajtjet e civilëve dhe për të lehtësuar dhënien e ndihmës urgjente. Të gjitha palët duhet të respektojnë detyrimet e tyre sipas ligjit ndërkombëtar humanitar dhe të drejtave të njeriut dhe të mbrojnë civilët. Një armëpushim i menjëhershëm dhe paqja janë një parakusht për sigurinë ushqimore dhe të Drejtën për Ushqim si një e drejtë themelore e njeriut", u shpreh Dongyu.

nga fillimi i armiqësive aktuale dhe ndërprerja e furnizimit me ujë, ushqim dhe furnizimi me karburant. Aktivitetet e peshkimit dhe blegtorisë, si dhe prodhimi i frutave dhe perimeve të freskëta janë ndaluar duke reduktuar aksesin në burimet kritike të proteinave dhe ushqimeve me vlera ushqyese, si dhe burimet kryesore të punësimit dhe mjeteve të jetesës.

"Në këtë pikë, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) e konsideron të gjithë popullsinë civile në Gaza si të pasigurta në sigurinë ushqimore.

Në përputhje me mandatin e saj dhe në koordinim me

Përfaqësues nga biznesi dhe institucionet e linjës diskutojnë mbi sfidat dhe identifikimin e nevojave të sektorit të fruta-perimeve

Në ambientet e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), u zhvillua tryeza e rrumbullakët

produkteve, mekanizimin e mjeteve, ndërgjegjësimin për certifikimet sigurimin e kreditimit të eksporteve,

rritjen e eksporteve të produkteve të fruta-perimeve, dedikimin e granteve për mbështetjen e këtij sektori, promovimin e kompanive të këtij sektori për pjesëmarrje në panaire kombëtare dhe ndërkom-bëtare, etj.

Gjithashtu, u dhanë sugjerime me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimin mes palëve dhe të gjithë aktorëve të ekosistemit, në mënyrë që përfitimet që ky sektor sjell, të jenë sa më funksionale dhe në dobi të të gjithë palëve.



me aktorët e sektorit të fruta-perimeve, me temë "Sfidat dhe identifikimi i nevojave të sektorit".

Ky aktivitet i organizuar nga AIDA, mbledhi bashkë përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, GIZ Albania, RisiAlbania, Creative Business Solution (CBS), Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), SIPPO Albania, Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë në Shqipëri (ITC), Bioinspekta si dhe përfaqësues të bizneseve të këtij sektori.

Pjesëmarrësit diskutuan rreth nevojave të sektorit, që lidhen me bashkëpunimin midis aktorëve dhe grupeve të interesit, grupimin kolektiv të fermerëve, sigurimin e cilësisë dhe standarteve të



Turizmi liqenor në Malësinë e Madhe, projekte për përmirësimin e infrastrukturës

E njohur si një zonë me traditë dhe histori të lashtë, në Malësi të Madhe po merr vëmendje edhe turizmi liqenor.

Dy vitet e fundit, resortet e ngritura pranë vijës liqenore të favorizuar nga ndërtimi i infrastrukturës rrugore po tërheqin vizitor të shumtë vendas dhe të huaj, të cilët kërkojnë të njihen me kulturen, traditën dhe historinë e kësaj treve. Për nënkryetarin e bashkisë Malësi e Mad-

he Sytki Ndrecaj nga bregu liqenor deri te zonat malore ky vit i ka kaluar pritshmëritë.

Bashkia e Malësisë së Madhe bashkë me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, kanë në projekt ndërtimin e rrugëve të cilat të çojnë në pikat turistike duke qënë se aktualisht disa të tilla nuk janë në gjendje të favorshme për një zonë të tillë.

Nisur dhe nga numri i lartë

i vendeve turistike që përfshin, Malësia e Madhe ka tërhequr një numër të lartë vizitorësh. Liqeni dhe mali mund të vizitohen mbrenda pak minutave, ndërsa ndërtimi i disa resorteve të reja, kanë nxitur një turizëm të sukseshëm. "Vermoshi, Lëpusha mbajnë rekordin e prenotimeve, ndërsa të edhe zonat e tjera si Razma por dhe vija liqenore kanë një numër të lartë turistësh.

Industria përpunuese plotëson pritshmëritë, problem çmimi i shitjes për fermerin

Qarku i Korçës prodhon masivisht mollë e një pjesë e mirë e prodhimit shkon për industrinë e prodhimit. Për këtë vit, sasia e frutit të përdorur si lëndë e parë, i ka plotësuar nevojat e këtij sektori.

Prodhuesi Petrit Hajdërlli bën me dije se prodhimin gjatë këtyre

viteve, kryesisht e ka eksportuar ndërsa së fundmi, vihet re një rritje e kërkesës nga tregu vendas.

Por për Petritin problem vizon të ngelet çmimi i tregimit të këtij fruti, i cili për fermerin është tepër i ulët, duke mos arritur të mbulojë kostot e prodhimit. Hajdërlli thotë se duhen

marrë masa për të vendosur një rregullator tregu në mënyrë që kjo situatë të marrë zgjidhje.

Sa i takon mollës së konsumit, ajo shitet kryesisht në tregun vendas e më pak në vendet e rajonit. Gjatë vitit të kaluar në Qarkun e Korçës u prodhua rreth 65 mijë ton mollë.

MOZAIK

Shqipëri, bie këtë vit prodhimi i ullirit, dyfishohet çmimi i vajit

Prodhimi i ullirit këtë vit shënon rënie në Shqipëri dhe kjo po shoqërohet edhe me dyfishimin e çmimit të vajit të ullirit.

Në vend nuk ka më sasi vaji të viteve të shkuar pasi sipërmarrjet dhe fermerët i shitën ato tek sipërmarrjet e huaja në gjashtë muajt e parë të këtij viti.

Eksportet e vajit të ullirit këtë vit shkuan në rreth 7500 tonë me një rritje të ndjeshme drejt vendeve fqinje Italisë dhe Greqisë.

Masivet me ullin në Shqipëri kanë këtë vit një prodhim më të pakët se viti i shkuar kur prodhimi i ullirit shkoi në rreth 160 mijë tonë.

Në Vlorë, një zonë e njohur për kultivimin e ullirit, fabrikat e prodhimit të vajit kanë nisur të punojnë me ritme të ulta.

Drejtori i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Vlorë Meno Besimaj thotë se në një vlerësim të përgjithshëm të kësaj qendre, e cila mbulon në nivel kombëtar problematikat e ullirit dhe vajit, ka një prodhim më të ulët të ullirit, por një çmim më të rritur të vajit.

“Në përgjithësi situata e prodhimit të ullirit sivjet është

në nivele më të ulta krahasuar me vitin e shkuar pasi viti 2022 ishte një vit me prodhimtari të lartë të ullirit, rreth 160.000 tonë në shkallë vendi. Ka një gjë pozitive këtë vit për fermerët pasi çmimi do të jetë gati dyfish krahasuar me një vit më parë”.

Edhe Enerik Xhaferaj, një prodhues i vajit të ullirit, thotë se këtë vit çmimi i vajit të ullirit është dyfishuar.

Çmimi i vajit këtë vit është pothuajse dyfishuar. Nga 4 mijë lekë që ishte për litër vitin e shkuar, sivjet ka shkuar në tetë deri në dhjetë mijë lekë “

Qendra e Transferimit të Teknologjive në Vlorë që ka një plantacion ulliri ka arritur të shesë këtë vit në ankand sasinë e ullirit me një çmim gati dyfish se një vit më parë.

“Çmimi është rritur pasi oferta këtë vit është me lartë, sasia e prodhimit është më e ulët, por duke qenë se edhe konsumi po rritet, pasi popullsia ka filluar të ndërjegjësohet për një përdorim më të madh

të vajit të ullirit. Kuptohet që edhe vendet si Italia, Spanja kanë pasur një prodhim më



të ulët dhe duke qenë se përpunuesit e vajit të ullirit kanë lidhur kontrata për eksport, detyrohen ti respektojnë ato. Lidhur me rritjen e çmimit po përmend vetëm një fakt: ne kemi plantacionin e ullirit këtu tek qendra jonë dhe sivjet në ankand çmimin e ullirit kokërr ne e kemi pasur 80-90% më shumë se vitet e kaluara.”

Zoti Besimaj thotë më tej se vitin e kaluar shkoi drejt eksportit edhe prodhimi stok i va-

më të lartë nga vendet e tjera duke pasur parasysh që shpenzimet më të mëdha tek ne lidhen me vjeljen.”

Fermerët edhe këtë vit, thotë prodhuesi Xhaferaj po e kthejnë prohimin në vaj dhe nuk po e shesin duke pritur të ndodhë situata e vjetshme kur ta rikthejnë për ta eksportuar me një çmim më të favorshëm.

“Fermerët nuk po shesin vajin që bëjnë por praktikojnë metodën që ndoqën vjet, e marrin vajin në shtëpi dhe do ta kthejnë kur të hapet tregu i eksportit. Nuk e di sa do funksionojë kjo këtë vit.”

Zoti Xhaferi thotë e fabrika e tij ka kapacitet depozitimi por situata e paqëndrueshme e çmimit i bën fermerët të mos i depozitjnë sasinë e vajit që prodhojnë në fabrikë.

“Kemi edhe depozita, edhe mundësi për ta grumbulluar, por ngaqë çmimi nuk është fiksi, fermerët po luhaten, nuk u pëlqen çmimi që ofrojnë fabrikat në këto momente dhe mendojnë se dor rritet më

shumë. Viten e shkuar shitja e vajit filloi me një çmim 3500 lekë të vjetra për litër dhe aritëri që e mori tregu italian 6000 lekë dhe fermerët u tunduan disi. Dhe këtë vit kjo po ndodh.”

Ndërsa zoti Besimaj thotë se ka ardhur koha që fabrikat duhet ti hedhin sytë nga depozitimi

“Fermeri duhet të marrë sasinë që do t'i duhet për konsumin vetjak dhe pjesën tjetër ta lërë ta shesë në fabrikë. Pra fabrikat duhet të jenë në depozitim, në marketim, në etiektim që ti rritet ciëlsia dhe zinxhiti i vlerës prodhimit të vajit të ullirit.”

Sipas të dhënave zyrtare në 8 muajt e këtij viti Shqipëria eksporto rreth 7500 tonë vaj ulliri që i përkaisn prodhimit të vitit të shkuar apo viteve më parë, në vlerën e mbi 26 milionë dollarëve.

Të dhënat e doganave shqiptare dëshmojnë se një litër vaj ulliri u eksportua mesatarisht me 3,5 dollarë një çmim i ulët krahasuar me kostot e fermerëve dhe fabrikave vendase.

Shqipëria është një nga vendet kryesore në Europë për kultivimin e ullirit me rreth 12 milionë rrënjë ullinj, nga të cilat rreth 11 milionë janë në prodhim.

Midhja e Butrintit, Hysen Mane, 70-vjeçari që prej 3 dekadash i është kushtuar kultivimit të saj

Në jug të Shqipërisë gjendet Liqeni i Butrintit i cili është i njohur për rritjen e midhjes. Midhja e Butrintit konsiderohet mjaftë e veçantë, për madhësinë e saj dhe shijen.

Prodhimi në Lagunën e Butrintit është një traditë shumë vjeçare. Vendasit e cilësojnë lagunën si vendin ideal për prodhimin e midhjeve.

Po ajo nuk rritet vetiu, duhet t'i shërbesh, thonë ata.

Një ndër ata që i shërben midhjes që pas vitit 1990 është 70-vjeçari Hysen Mane. Ai e ka nisur si qeraxhi i disa impianteve prej betoni të trashëguara nga ish ndërmarrja shtetërore e peshkimit. Impiantet e instaluar

në Liqenin e Butrintit, të quajtur ndryshe edhe krevatinat e midhjes, kanë qenë këtu që prej vitit 1960, por tani ka ndryshuar teknologjia dhe mënyra e trajtimit.

Hyseni tregon se me kalimin e viteve duke u marrë me këtë punë, ka fituar eksperiencën e nevojshme për t'u bërë

një mjeshtër e pronar i dhjetëra impianteve të teknologjisë bashkëkohore. Pas 33 viteve



punë, ai është i organizuar si një linjë e plotë së bashku me familjen e vet të cilës ia ka trashëguar këtë profesion kaq të bukur.

Mjeshtri i midhjes Mane thotë se kjo punë ka bukurinë dhe fitimin e vet. Ai thotë se Midhja e Butrintit është më e mira, më e shijshmeja dhe më e

kërkuara nga turistët vendas e të huaj. Sekretit thotë ai është tek vetë liqeni me dy kate, ku janë

kërkuara nga turistët vendas e të huaj. Sekretit thotë ai është tek vetë liqeni me dy kate, ku janë

kërkuara nga turistët vendas e të huaj. Sekretit thotë ai është tek vetë liqeni me dy kate, ku janë

kërkuara nga turistët vendas e të huaj. Sekretit thotë ai është tek vetë liqeni me dy kate, ku janë

kërkuara nga turistët vendas e të huaj. Sekretit thotë ai është tek vetë liqeni me dy kate, ku janë

kërkuara nga turistët vendas e të huaj. Sekretit thotë ai është tek vetë liqeni me dy kate, ku janë

Shkencëtarët kinezë parashikojnë 10 për qind zgjerim të tokës së thatë në nivel global deri në vitin 2100

Shkencëtarët kanë parashikuar një reduktim të madh të ruajtjes së ujit tokësor në 70 vitet e ardhshme, shoqëruar me një zgjerim të tokave të thata globale deri në rreth 10 për qind, bëri të ditur Akademia Kineze e Shkencave (CAS).



Reduktimi i ruajtjes së ujit dominohet nga ndryshueshmëria e reshjeve dhe avullimit dhe mund të arrijë në 41 deri

në 84 për qind deri në vitin 2100, bëhet e ditur në studimin e botuar në revistën “Climate and Atmospheric Science”, citon “Xinhua”.

Për të kuptuar reagimin e ruajtjes së ujit tokësor ndaj rritjes së bimësisë së tokës së thatë, një ekip kërkimor nga

Instituti i Kërkimeve të Informacionit të Hapësirës Ajrore nën Akademisë Kineze të Shkencave kreu studimin ba-

zuar në vëzhgimet satelitore dhe rezultatet e modelit. Ata vunë re një rritje të përgjithshme të rritjes së bimësisë nëpër tokat e thata në mbarë botën midis viteve 1982 dhe 2016, gjatë së cilës depozitimi i ujit tokësor në këto rajone u ul. Gjetjet tregojnë një korrelacion negativ midis dy treguesve, veçanërisht në zonat e dominuara nga toka bujqësore.

Duke përdorur vëzhgimet me sensorë në distancë, simulimet e modeleve dhe metodat e mësimin të makinerive, ekipi i studuesve parashikoi më tej se tokat e thata globale mund të zgjerohen me 4.1 deri në 10.6 për qind deri në vitin 2100, me një reduktim të madh në ruajtjen e ujit tokësor.

Sipas studimit, gjetjet nëvizojnë nevojën për planifikim të bashkërenduar për restaurimin e ekuilibruar ekologjik, menaxhimin bujqësor dhe shfrytëzimin e burimeve ujore.

Sipas studimit, gjetjet nëvizojnë nevojën për planifikim të bashkërenduar për restaurimin e ekuilibruar ekologjik, menaxhimin bujqësor dhe shfrytëzimin e burimeve ujore.

Sipas studimit, gjetjet nëvizojnë nevojën për planifikim të bashkërenduar për restaurimin e ekuilibruar ekologjik, menaxhimin bujqësor dhe shfrytëzimin e burimeve ujore.

Sipas studimit, gjetjet nëvizojnë nevojën për planifikim të bashkërenduar për restaurimin e ekuilibruar ekologjik, menaxhimin bujqësor dhe shfrytëzimin e burimeve ujore.

Sipas studimit, gjetjet nëvizojnë nevojën për planifikim të bashkërenduar për restaurimin e ekuilibruar ekologjik, menaxhimin bujqësor dhe shfrytëzimin e burimeve ujore.

Sipas studimit, gjetjet nëvizojnë nevojën për planifikim të bashkërenduar për restaurimin e ekuilibruar ekologjik, menaxhimin bujqësor dhe shfrytëzimin e burimeve ujore.

Sipas studimit, gjetjet nëvizojnë nevojën për planifikim të bashkërenduar për restaurimin e ekuilibruar ekologjik, menaxhimin bujqësor dhe shfrytëzimin e burimeve ujore.

Sipas studimit, gjetjet nëvizojnë nevojën për planifikim të bashkërenduar për restaurimin e ekuilibruar ekologjik, menaxhimin bujqësor dhe shfrytëzimin e burimeve ujore.

Sipas studimit, gjetjet nëvizojnë nevojën për planifikim të bashkërenduar për restaurimin e ekuilibruar ekologjik, menaxhimin bujqësor dhe shfrytëzimin e burimeve ujore.

7 kompani shqiptare në panairin BIOFACH 2020, promovim bimëve mjekësore dhe ushqimit organik

7 kompani shqiptare kanë konfirmuar pjesëmarrjen në panairin ndërkombëtar “BIOFACH 2024”, më të madhin që organizohet për bimët mjekësore dhe ushqimin organik dhe që zhvillohet në Nuremberg, Gjermani, nga datat 13-16 shkurt 2024.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) bëri të ditur pjesëmarrja në këtë panair luan një rol të rëndësishëm në promovimin e Shqipërisë si destinacion me

potencial shumë të madh zhvillimi për bimët mjekësore dhe prodhimet organike.

Në kuadër të një përfaqësimit sa më të mirë të këtij sektori në këtë event të rëndësishëm, MBZHR dhe AIDA kanë nisur përgatitjet për t'iu siguruar kompanive pjesëmarr-

rëse pjesëmarrje dhe mundësi takimi me kompanitë e interesuara për partneritet.

Në këtë takim e organizuar sot nga autoritet në Tiranë, ishin prezentë përfaqësues nga 7 kompanitë që do të jenë pjesë e standës shqiptare. Gjatë takimit u bë një prezantim i përgjithshëm i pa-

nairit, si dhe u diskutua në lidhje me objektivat dhe pritshmëritë e kompanive pjesëmarrëse.

BIOFACH është një ngjarje e rëndësishme biznesi në sektorin e bimëve mjekësore dhe ushqimit organik, ku këtë vit marrin pjesë rreth 4000 mijë ekspozues nga e gjithë bota. Ky

event zhvillohet për të 30-ën herë radhazi dhe shihet si një histori suksesi e jashtëzakonshme. BIOFACH pritet të krijojë mundësi për bashkëpunime dhe shtrirje në tregjet e huaja, promovimin e Shqipërisë si destinacion me potencial shumë të madh zhvillimi për bimët

event zhvillohet për të 30-ën herë radhazi dhe shihet si një histori suksesi e jashtëzakonshme. BIOFACH pritet të krijojë mundësi për bashkëpunime dhe shtrirje në tregjet e huaja, promovimin e Shqipërisë si destinacion me potencial shumë të madh zhvillimi për bimët



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA
LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



AGROTURIZËM

Rama: Agroturizmi do vijojë të rritet, po shtrihet deri në zona të thella

Kryeministri Edi Rama theksoi se investimi në agroturizëm është sukses i sigurtë.

Gjatë fjalës së tij në Asamblenë e Zgjeruar të PS-së në Pogradec, Rama tha se “ne sot pamë zhvillimin e punimeve në një kantier të rëndësishëm për Pogradecin, në zonën e Tushemishtit ndërkohë që kemi të tjera projekte që do të vazhdojnë të realizohen hap pas hapi, por të gjitha këto janë një zinxhir i mirëplanifikuar punësh që bashkohen me përpjekjen e individëve të sipërmarrjeve për të marrë pjesë në këtë zhvillim dhe për të përfituar nga ky zhvillim”.

“Nëse këtë vit, Pogradeci, Korça, Devoll, Maliqi, Erseka kanë njohur një hov të ri të turizmit, duhet të jemi të për-

gatitur që vitin e ardhshëm do të jenë më shumë dhe duhen edhe më shumë dyer të hapura për t'i mikpritur dhe më shumë prodhim dhe shërbime për t'ju siguruar atyre dhe për të marrë mbrapsht fitimin e merituar. Është një mundësi, e cila sot fatmirësisht po shohim se po shtrihet shumë përtej zonave tradicionale dhe po shkon nëpër fshatra, në zona të thella dhe do vazhdojë duke u rritur gjithmonë e më shumë”, nënvizoi Rama.

Kreu i qeverisë u shpreh se “sot të investosh në një agroturizëm në Ersekë, Devoll apo



Pustec është sukses i sigurt në vend se të mbash kazmën apo ministrinë apo barrën e të punuarit për dikë tjetër në Greqi, Itali,

Angli. Flas për të gjithë ata që bëjnë punë të zakonshme dhe pastaj në fund të muajit mos ngelet më asgjë. Të investosh kursimet kur ke mundësinë ta bësh këtë në fshat, në cilindo fshat, është e sigurt që në fund të muajit të lë diçka dhe këtë sot nuk e them unë, e thonë faktet e të gjithë atyre që e kanë bërë këtë”.

“Është një kullë në fund të botës, në zonën e Bulqizës. Nëse do shikoni historinë e asaj kulle se si ajo familje e ka transformuar në një destinacion turistik ku nuk keni idenë sesa më e vështirë është

të shkosh, sesa të shkosh në cilëndo pikë këtu rreth e rrotull dhe të shikoni se si ata jetojnë me atë punë dhe nxjerrin fitim nga ajo punë dhe kanë gjithmonë e më shumë njerëz që kërkojnë të shkojnë tek ata dhe ka edhe më pak vende të lira sepse duhet të rezervosh”, tha Rama.

Prandaj, vijoi Rama, dua ta përsëris sa herë të mundem që koha kur shkoje në Evropë dhe mund të kurseje mjaftueshëm për të imagjinuar të bëje gjëra të tjera ka mbaruar, nuk është më.

“Jemi në një moment ku i kemi të gjitha faktet se synimin për të arritur në një majë të re në 2030 e kemi të mbështetur, jo më një dëshirë, por një synim të mbështetur”, tha Rama.

JICA mbështet Shqipërinë për paralajmërimin e zjarreve në pyje

Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) dhe Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile (AKMC) nisin bashkëpunimin për ngritjen e kapaciteteve për Sistemin Kombëtar të Informacionit të Zjarrit në Pyje dhe zgjidhjeve të bazuara në natyrë për reduktimin e rrezikut ndaj fatkeqësive.

Kryepërfaqësuesi i JICA për Rajonin e Ballkanit Ueki Masahiro dhe drejtori ipërgjith-


macionit për Zjarret në Pyje (NFFIS) dhe për të pilotuar zgjidhje të bazuara në natyrë për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë (NbS-DRR).

Trajnime në Japoni apo vende të tjera, në lidhje me arritjen e qëllimeve të sipërpërmendura, janë planifikuar gjithashtu të ndërmerren përmes mbështetjes së JICA, për personelin e AKMC dhe organizatave të tjera qeveritare që do të përfshihen në zbatimin e pro-

shfaqjes dhe zonat e rrezikuara janë rritur në Shqipëri. Nga viti 2012 deri në vitin 2017, numri mesatar i zjarreve në vit ishte 214, dhe sipërfaqja e djegur në vit ishte 3,476 ha (duke përfshirë kullotat). Shqipëria është në rrezik nga efektet e valëve të të nxehtë dhe zjarreve. Me temperaturat më të larta të verës dhe kushtet gjithnjë e më të thata, frekuenca dhe madhësia e zjarreve në pyje ka të ngjarë të rritet më tej.

JICA, ka zbatuar bashkëpunimin në fushën e Sistemeve të Informacionit për paralajmërimin e hershëm të Zjarreve në Pyje dhe Zgjidhjeve të bazuara në Natyrë për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë NbS-DRR (ose Eco-DRR) në Ballkanin Perëndimor, në vendet për rreth Shqipërisë. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, JICA ka zhvilluar dhe prezantuar sisteme të shkallëzueshme kombëtare të informacionit për zjarret në pyje, të cilat janë efektive kundër zjarreve në pyje dhe fatkeqësive të tjera, si dhe parandalimin e fatkeqësive natyrore përmes demonstrimit të “reduktimit të

projektit, me qëllim rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore. Gjithashtu, në kuadër të kësaj nisme një numër pajisjesh do



shëm i AKMC, Haki Çako, nënshkruan sot në mjediset e Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile në Tiranë, marrëveshjen për zbatimin e Projektit të Bashkëpunimit Teknik “Për Ngritjen e Kapaciteteve për Sistemin Kombëtar të Informacionit të Zjarrit në Pyje (NFFIS) dhe Zgjidhjeve të bazuara në Natyrë për Reduktimin e Rrezikut të Fatkeqësive (NbS-DRR)”.

Qëllimi i projektit është krijimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të emergjencave në Shqipëri dhe zhvillimin e kapaciteteve të agjencive qeveritare për paralajmërimin e hershëm për zjarret në pyje dhe fatkeqësitë e tjera natyrore, si dhe aplikimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë përmes pilotimit në zona të caktuara (zona e ujëmbledhësit të Bovillës), duke synuar reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Nëpërmjet këtij Projekti të Bashkëpunimit Teknik, ekspertët japonezë të JICA-s do të vijnë në Shqipëri, për të ndihmuar AKMC për të zbatuar Sistemin Kombëtar të Infor-



t'i sigurohen AKMC nëpërmjet këtij bashkëpunimi teknik.

Projekti i bashkëpunimit nisë në 6-mujorin e parë të vitit 2024 dhe do të vijojë për një periudhë 5 vjeçare.

Shqipëria vitet e fundit është përballuar me rrezikun e ndryshime klimatike, me zjarret në pyje, përmytjet, rrëshqitjet e dherave dhe tërmetet. Përafërsisht 39.9% e terrenit në vend është pyll, dhe zjarret në pyje janë të zakonshme gjatë muajve të thatë të verës. Shpeshtësia e

rrezikut të fatkeqësive të bazuara në ekosistemin (Eco-DRR)”. Duke qenë se rreziku nga zjarri në pyje është çështje ndërkufitare, prezantimi i NFFIS dhe NbS-DRR në Shqipëri konsiderohet i dobishëm si për Shqipërinë ashtu edhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Mjedisi është një nga fushat prioritare të politikës japoneze të asistencës për Shqipërinë. Ky projekt konsiderohet si aktivitet thelbësor për mbrojtjen e mjedisit në vendin tonë.

BE - Gjermani, 14.6 milionë euro për zhvillimin e ekonomisë qarkulluese në Shqipëri

Bashkimi Evropian dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) prezantuan projektin e ri “BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Ekonomia Qarkulluese për Zhvillimin Urban të Qëndrueshëm”.

Të pranishëm në ceremoninë e prezantimit të projektit të ri ishin ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro dhe ambasadori gjerman në Shqipëri, Karlfried Bergner.

Kumbaro dhe Bergner vlerësuan projektin e ri, i cili do të kontribuojë në zbatimin e standardeve evropiane mjedisore dhe parimet e ekonomisë qarkulluese në Shqipëri.

Hubert Perr, shef i Bashkëpunimit në Delegacionin

Ndërsa Marion Fleuth-Leferink nga ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ),

vite dhe financim 14.6 milionë euro, projekti do të ndihmojë Shqipërinë të zvogëlojë mbetjet dhe të kalojë drejt



theksoi se “zbatimi i parimeve të ekonomisë qarkulluese në menaxhimin e mbetjeve do të zvogëlojë përdorimin e burimeve natyrore dhe do të nx-

modelit të ekonomisë qarkulluese përmes: zhvillimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve në përputhje me standardet e BE-së, përfshi trajnimin për zbatimin dhe monitorimin; prezantimit të modeleve të biznesit të gjelbër Përgjegjës inë e Zgjeruar të Prodhuetit (EPR) për tri rryma mbetje; mbështetjes së masave të ekonomisë qarkulluese në 15 bashki partnere, për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve, zhvillimit dhe përmirësimit të masave ricikluese si Impjante Kompostimi dhe Trajtimi të Mbetjeve.

Projekti do të punojë me bizneset, organizatat jofitimprurëse dhe akademinë për të nxitur zhvillimin e produkteve inovative me bazë gjinore, shërbimet dhe modellet e biznesit të ekonomisë qarkulluese.

Bashkimi Evropian është partneri më i rëndësishëm i Shqipërisë në fushën e zhvillimit, duke ofruar më shumë se 100 milionë euro çdo vit asistencë përmes granteve, për të mbështetur qytetarët shqiptarë dhe për të ndihmuar Shqipërinë të përshatë dhe të zbatojë reformat politike, institucionale, shoqërore dhe ekonomike për t'u përafëruar me vlerat e BE-së dhe rregullat e saj.



e BE-së në Shqipëri tha se “menaxhimi i mbetjeve është thelbësor në kalimin drejt një të ardhme më të shëndetshme dhe më të pastër. Sot në Shqipëri, vetëm 76% e mbetjeve shtëpiake mblidhen çdo vit, dhe vetëm 18% riciklohet. Duke përpunuar dhe ripërdorur këto mbetje, ne jo vetëm mund të zvogëlojmë ndikimin në mjedis, por gjithashtu mund të krijojmë dhjetëra-mijëra vende të reja pune. BE, si udhëheqësi global i mjedisit është e lumtur të mbështesë Shqipërinë në zhvillimin e ekonomisë qarkulluese, për të përmirësuar jetesën e shqiptarëve në perspektivën e anëtarësimit të Shqipërisë në BE”.

isë një ekonomi të fortë dhe ripërtëritëse, duke krijuar vende të reja pune në vend”.

“Projekti “BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Ekonomia Qarkulluese për Zhvillimin Urban të Qëndrueshëm” do të mbështesë transformimin e kuadrit ligjor të Shqipërisë dhe zbatimin e strategjive të Kapitullit 27 – mjedisit, në përputhje me Direktivën e BE-së. Kjo do të shërbejë si një shembull për të gjithë rajonin dhe më gjerë”, tha Fleuth-Leferink.

Projekti po zbatohet nga GIZ Shqipëri, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të Republikës së Shqipërisë.

Me një kohëzgjatje 3.5

(Vijon nga numri i kaluar)

RisiAlbania mbështet webinarin mbi Turizmin e Qëndrueshëm

Shqipëria mund të rrisë potencialet e saj ekonomike duke shfrytëzuar më mirë zhvillimin e qëndrueshëm të Turizmit

Me përvojë në komunikim, marrëdhënie me publikun dhe gazetari për mbi 15 vjet, Eva Kushova u fokusua në fushën e turizmit në vitin 2014, fillimisht me marketingun e turizmit duke ndihmuar bizneset turistike të promovonin produktet e tyre në tregjet në mbarë botën dhe më vonë duke u fokusuar në marketingun e destinacioneve. E trajnuar dhe certifikuar



Eva Kushova
Eksperte e Turizmit

në fushën e Turizmit të qëndrueshëm nga GSTC, Kushova iu bashkua webinarit mbi Turizmin e Qëndrueshëm.

Seksioni i 2-të u fokusua tek: Standardet e turizmit të qëndrueshëm dhe kriteret (angazhim i pjesëmarrjeve, pyetësor) dhe Seksioni 3-të: Shqipëria - raste studimi.

Seksioni i II KRITERET PËR TURIZMIN E QËNDRUESHËM Çfarë është GSTC (Global Sustainable Tourism Council)

- Autoritet drejtues në vendosjen dhe menaxhimin e standardeve për turizmin e qëndrueshëm

- Organizatë që vepron si organ ndërkombëtar akreditues për certifikimin e turizmit të qëndrueshëm.

Dy lloj kriteresh për turizmin e qëndrueshëm (në 33 gjuhë, edhe shqip)

- Kriteret për Destinacione dhe qeveritë

- Kriteret për industrinë

1. Hotele
2. Tur operator

Kriteret e GSTC për Destinacionin

- Udhëzime bazë për destinacionet që dëshirojnë të bëhen më të qëndrueshme

- Ndihmojnë konsumatorët të identifikojnë destinacione të qëndrueshme

- U ofrojnë programeve qeveritare, joqeveritare dhe sektorit privat një pikënisje për zhvillimin e kërkesave të turizmit të qëndrueshëm

- Shërbejnë si udhëzime bazë për organet e edukimit & trajnimit, shkollat, universitetet

DMO në Shqipëri?

- Ligji i ri për Turizmin

- **Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 93/2015, "Për Turizmin", i ndryshuar**

Organizata e Menaxhimit të Destinacionit (OMD)" është një entitet udhëheqës organizativ që përfshin institucione publike, aktorë dhe profesionistë të turizmit dhe mundëson partneritete të sektorit të turizmit drejt një vizioni të përbashkët të destinacionit turistik.

Struktura administrative e OMD-s varion nga një institucion i vetëm publik, në një model partneriteti publik/privat ose OJF me rol kryesor nisjen, koordinimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të tilla si zbatimimi i politikave të turizmit, planifikim strategjik, zhvillim produkti, promocion, marketing dhe aktivitete të "biznesit të turizmit"

4 Shtyllat e Turizmit të Qëndrueshëm

- a. Menaxhim i Qëndrueshëm
- b. Qëndrueshmëria ekonomiko sociale
- c. Qëndrueshmëria Kulturore
- d. Qëndrueshmëria mjedisore

A. Menaxhim i Qëndrueshëm

A1 Sistemi i menaxhimit të qëndrueshmërisë

Biznesi zbaton një sistem afatgjatë të menaxhimit të qëndrueshëm, adreson çështje mjedisore, social-ekonomike, kulturore

A4 Përfshirja e personelit

Personeli përfshihet në zhvillimin dhe zbatimin e sistemit merr udhëzime dhe trajnime periodike

A5 Eksperiencia e konsumatorëve

Kënaqësia e konsumatorit, përfshij aspektet e qëndrueshmërisë, monitorohet dhe ndërmerren masa korrigjuese.

A7 Godinat dhe infrastruktura

Gjate planifikimit, projektimit, ndërtimit, rinovimit të hotelit, ndertesës tuaj

A7.2 Impakti dhe integriteti ...

Merrni në konsideratë kapacitetin dhe integritetin natyror dhe kulturor i zonës

7.4 Ofron akses për të gjithë

Ofroni akses dhe informacion për personat me nevoja të veçanta, kur është rasti i duhur.

7.3 Praktika dhe materiale të qëndrueshme

Përdoren materiale dhe praktika të qëndrueshme të përshtatshme për zonën.

B: Qëndrueshmëria ekonomiko sociale

Banorëve vendas u jepen mundësi të barabarta punësimi dhe avancimi në karrierë, duke përfshirë pozitave drejtuese.

B3 Blerje Lokale

Kur blen dhe ofron mallra dhe shërbime, organizata u jep përparësi furnizuesve lokalë dhe të tregtisë së ndershme sa herë që këto janë të disponueshme dhe me cilësi të mjaftueshme.

B4 Sipërmarrësit lokal

Organizata mbështet sipërmarrësit lokal për prodhimin dhe zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të qëndrueshme, sidomos ata që operojnë në zonat natyrore, historike dhe kulturore

B6 Mundësi të barabarta

Organizata ofron mundësi punësimi, duke përfshirë edhe pozicione drejtuese, pa diskriminim sipas gjinisë, racës, fesë, aftësisë së kufizuar ose në mënyra të tjera.

C. Qëndrueshmëria kulturore

C1 Ndërveprimet kulturore
Organizata ndjek praktikën e mira për menaxhimin dhe promovimin e vizitave në vendet e ndjeshme kulturore ose historike për të minimizuar ndikimet negative dhe për të maksimizuar përfitimet lokale dhe përmbushjen e vizitorëve.

C2 Mbrojtja e trashëgimisë kulturore

Organizata kontribuon në mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e pronave lokale, vendeve dhe traditave me rëndësi historike, arkeologjike, kulturore dhe shpirtërore. Kjo lejohet hyrjen në to nga banorët.

C3 Prezantimi i kulturës dhe trashëgimisë.

Organizata vlerëson dhe përfshin elemente autentike të kulturës tradicionale dhe bashkëkohore lokale në funksionimin, dizajnin, dekorimin, ku-

zhinën ose dyqanet e saj, duke respektuar të drejtat e pronësisë intelektuale të komuniteteve lokale.

C4 Artefakte

Artefaktet historike dhe arkeologjike nuk shiten, tregohen ose ekspozohen, përveç kur lejohet nga ligji ndërkombëtar apo local..

D. Qëndrueshmëria mjedisore

D1.1 Blerjet e mallrave miqësore për mjedisin

Politikat e blerjes favorizojnë furnitorët dhe produktet miqësore për mjedisin, përfshij pajisje, produkte ushqimore, piqe, materiale ndërtimi

D1.3 Kursimi i energjisë

Matet konsumi i energjisë sipas llojit dhe ndërmerren masa për minimizimin e konsumit. Biznesi bën përpjekje për rritjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme

D1.4 Kursimi i ujit

Vlerësohet risku i mungesës së ujit, matet konsumi i ujit sipas llojit, dhe merren hapa për minimizimin e konsumit të përgjithshëm.

D2.2 Transporti

Biznesi kërkon të reduktohen nevojat për transport dhe inkurajon fort përdorimin e alternativave nga burime më të pastra dhe efikase nga gjithë konsumatorët, punonjësit dhe furnitorët në të gjitha operacionet.

D2.3 Ujërat e zeza

Ujërat e zeza, përfshij ujën gri, trajtohen me efikasitet dhe ripërdoren ose shkarkohen në mënyrë të sigurt, pa efekte negative në popullatën ose mjedisin lokal.

Seksioni i III SHQIPËRIA, PRAKTIKAT MË TË MIRA

Mrrizi i Zanave, Fishte, Lezhë
Nuk ndjekin program për kriteret e Turizmit të qëndrueshëm, por janë lider për praktikën që ndjekin

A. Menaxhimi i qëndrueshëm (toka në pronësi, praktikë dhe materialet e qëndrueshme në nivel lokal).

B. Ndikimi ekonomik dhe social (b1-B4) Punësimi i njerëzve vendas, më shumë se 400 njerëz Përfitimi shpërndahet për komunitetin. KM 0.

C. Ndikimi kulturor. Ruajtja e traditave, ndërtesat e vjetra dhe historinë e zonës

D. Mjedisi, panelet diellore, kursimi i ujit, mospërdorimi i plastikës, riciklimi i ushqimit Mulliri i gurit që punon me panel diellor

Konkluzione: Nisni me hapa të vegjël!

• Plan/strategji për hapat drejt kriterëve të qëndrueshëm në zyrë dhe për klientët

• Reduktoni plastikën, zëvendësojeni me qelq, ose materiale të ripërdorshme

• Ricikloni produktet (p.sh. shambo rimbushese dhe jo një përdorimshme, me çarçafët e vjetër -peceta, rregulla për ripërdorimin e peshqireve, jo larjen e shpeshë..

• Përdorimi i mjeteve ekologjike të transportit (bicikleta, autobus publik, ecje)

• Zgjedhja e kujdesshme e furnitorëve të qëndrueshëm, eco friendly (psh për solucionet)

• Kurseni energji, investoni në panele. Kurseni ujin, impiante për ripërdorimin e ujit

• Blini ushqime lokale. Zbukuroni zyrën, hotelin me perde artizanale, suvenirë vendase.

• Punësoni personel vendas, motivimi financiarisht dhe në karriere për të qëndruar gjatë

• Përfshini stafin në të gjitha planet për zhvillim të qëndrueshëm

• Interpretoni sic duhet kulturën, traditën. Informoni turistin çfarë të mos bëjë..

• Mbroni speciet, zhvilloni biznesin pa demtuar rregullat e komunitetit.

Lushnje - Fermerët eksperimentojnë me kivi, klima e nxehtë nuk i lejon të kultivojnë frutin

Eksperimenti për të mbjellë frutin e kivit në Lushnje, ka sjellë dështimin e fermerëve. Klima nuk është e favorshme për rritjen e frutit, ndaj përpjekjet e disa prodhuesve, kanë qenë negative.

Një rast i tillë, tregohet nga një fermer i fshatit Skilaj.

Sami Nexha ka provuar të mbjellë kivin, një frut që askush nuk e ka kultivuar në këtë zonë.

Ideja lindi nga nevoja për konsum mjekësor, për sëmundjen e babait të tij, dhe me pas u kthye në produkt për të bërë tregti.

Prova që ai nisi 6 vjet më parë, sot nuk është në pritshmëritë e duhura.

Samiu tregon se, plantacioni me kivi, ndryshe nga pemët e tjera do shumë më tepër punë dhe se klima nuk ka qenë e

duhura për zhvillimin e frutit.

Në vitin e parë të prodhimit të kivit, fermeri nga Skilaj u përball me konkurrencën në treg, jo vetëm në çmim por edhe në cilësi.

Sipas tij, që të shtoj sipërfaqet apo të shpenzoj më tepër në këtë kulturë i duhet ndihma nga shteti, e cila deri tani i ka munguar.



"Krahasim me punën që kam bërë, nuk mbuloj dot shpenzimet që dhashë. Tregu është shumë i vështirë. Tregtarët marrim më shumë prodhimin që vjen nga jashtë pasi edhe kokrra është më e madhe se ajo e prodhimit vendas" shprehet ai.

Fermeri do të vazhdojë edhe disa vjet të punojë sipërfaqjen prej 2 dylmesh me kivi, përpara se të vendosë për ta shkullur.

Deri tani, klima e nxehtë e Lushnjes dhe toka në Skilaj nuk janë të përshtatshme për kultivimin e tij, ndaj dështimi është i sigurt.

Dështimi i këtij fermeri, mësoj shumë të tjerë, që të mos e kultivojnë kivin, por të keshillohen me specialistë përpara se të gjejnë farën që i duhet tokës.

Sezoni i gështenjave - Prodhim i ulët, mblidhen për konsum e jo për shitje

Njësit administrative Mal Zi në Kukës njihet si një nga prodhuesit e gështenjave.

Fshatrat e kësaj njësie si Shemri, Mguil, Kryemadh dhe Petkaj e tjerë e ka përqendruar të gjithë aktivitetin e tij pikërisht në këtë drejtim.

